Mal Berisha

ME TË PAHARRUARIN KADARENË E MADH!

Mëngjesi i datës 1 korrik 2018 filloi me një kafe përpara me gjeniun e letrave shqipe, Ismail Kadarenë, mbajtës i shumë çmimeve ndërkombëtare për letërsi. Ishte një nder i madh të ndjeje nga afër thellësinë e mendimit të tij filozofik dhe qasjen

historike ndaj shtratit tërësisht europian të kulturës iliro-shqiptare, mbi të cilën është zhvilluar kombi ynë. Të dëgjoje rrëfimet që na bëjnë krenarë për identitetin tonë kombëtar – nga Ai që ka kontribuar më shumë se kushdo tjetër në njohjen, rritjen e imazhit të kombit dhe respektin që bota ka sot për ne – ishte një përjetim i rrallë.

T'i dhuroja librat dhe të prisja opinionin e Tij – të gjitha ishin kënaqësi të veçanta. Dua t'i them:

Faleminderit, Kadare! Faleminderit edhe ty, z. Bujar Hudhri, themelues dhe President i *Onufrit*, botuesit të veprës së Kadaresë, për organizimin e këtij takimi kaq të çmuar dhe të paharrueshëm!